

Statistikat e transportit*

Qershor 2020

Tiranë, më 27 Korrik 2020: Në muajin Qershor 2020, volumi i mallrave dhe numri i pasagjerëve të transportuar me rrugë detare, ajrore dhe hekurudhore, i ndikuar dhe nga situata e krijuar nga Covid-19, rezultoi:

Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Qershor 2020 është 376 mijë tonë, duke u ulur 9,5%, krahasuar me Qershor 2019.

Në gjashtëmujorin e parë të 2020, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 2,0 milionë tonë, duke u ulur me 8,8 %, krahasuar me gjashtëmujorin e parë të 2019.

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë në muajin Qershor 2020 është 2,0 milionë tonë-kilometër, duke u ulur me 45,3 %, krahasuar me Qershor 2019.

Në gjashtëmujorin e parë të 2020, volumi i mallrave të transportuar me hekurudhë është 12,1 milionë tonë-kilometër, duke u ulur me 37,8 %, krahasuar me gjashtëmujorin e parë të 2019.

Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër

Periudha	Me det /tonë	Hekurudhë 000/tonë.km	Ajër /tonë
Qershor 2019	415.585	3.745	187.8
Qershor 2020	375.972	2.047	123.9
Ndryshimi vjetor (%)	-9,5	-45,3	-34,0
Janar-Qershor 2019	2.229.680	19.498	1.145.1
Janar-Qershor 2020	2.032.759	12.126	844.5
Ndryshimi vjetor (%)	-8,8	-37,8	-26,2

* Përfshin mallrat dhe postën

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT

Në muajin Qershor 2020, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 124 tonë mallra, duke u ulur me 34,0 %, në krahasim me Qershor 2019.

Në gjashtëmujorin e parë të 2020, me ajër janë transportuar 845 tonë mallra duke u ulur 26,2 %, krahasuar me gjashtëmujorin e parë të 2019.

Për publikim 27/07/2020

Vijon

Numri i fluturimeve të kryera, në Qershor 2020 është 460 duke shënuar një rënie me 82,5 %, ndaj Qershor 2019.

Tab. 2 Treguesit e transportit ajror

Periudha	Numri i shoqërive ajrore*	Numri i fluturimeve	Numri i mbikalimeve
Qershor 2019	20	2.626	21.661
Qershor 2020	16	460	2.443
Ndryshimi vjetor (%)	-20,0	-82,5	-88,7
Janar- Qershor 2019	20	12.723	81.236
Janar- Qershor 2020	16	5.578	33.765
Ndryshimi vjetor (%)	-20,0	-56,2	-58,4

*Numri i kompanive ajrore i referohet numrit të kompanive të cilat në fillim të vitit janë licensuar të kryejnë fluturime

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare në Qershor 2020 është 17.495 pasagjerë. Krahasuar me Qershor 2019, ky tregues është ulur 88,1 %. Në gjashtëmujorin e parë të 2020, kanë udhëtuar me linjë detare 152.337 pasagjerë, duke u ulur me 68,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Në muajin Qershor 2020, transporti ajror i pasagjerëve zë 61,9 % të transportit gjithsej. Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në gjashtëmujorin e parë të 2020 është 554.877 pasagjerë, duke u ulur me 60,7 %, krahasuar me gjashtëmujorin e parë të 2019.

Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Me hekurudhë	Me det	Me ajër
Qershor 2019	8.510	146.895	310.988
Qershor 2020	0	17.495	28.416
Ndryshimi vjetor (%)	-100,0	-88,1	-90,9
Janar- Qershor 2019	29.608	482.822	1.411.479
Janar- Qershor 2020	64	152.337	554.877
Ndryshimi vjetor (%)	-99,8	-68,4	-60,7

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit

Në Qershor 2020, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 75,0 mld lekë dhe 48,8 % e tyre u transportua me det.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 396,5 mld lekë dhe 50,6 % e tyre u transportua me det.

Tab. 4 Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit

Mënyra e transportit	Eksport (mln lekë)				Import (mln lekë)			
	Qershor 2019	Qershor 2020	Jan.-Qer. 2019	Jan.- Qer. 2020	Qershor 2019	Qershor 2020	Jan.- Qer. 2019	Jan.- Qer. 2020
Transport detar	14.819	12.171	90.077	70.577	26.885	24.448	155.828	130.101
Transport hekurudhor	1	-	4	-	284	215	2.038	1.564
Transport rrugor	9.961	10.686	59.622	52.421	23.018	25.297	135.026	124.651
Transport ajror	98	44	423	459	1.610	1.213	9.849	7.783
Të tjera	686	190	2.222	1.901	1.628	774	14.932	7.051


Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Eksportet e mallrave

Në Qershor 2020, mallrat e eksportuara me det zënë 52,7 %, me rrugë 46,3 % dhe me ajër 0,2 %. Mallrat e eksportuara me rrugë janë rritur me 7,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Në gjashtëmujorin e parë të 2020, mallrat e eksportuara me det zënë 56,3 %, me rrugë 41,8 % dhe me ajër 0,4 %. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020, mallrat e eksportuara me rrugë janë ulur 12,1%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Qershor 2020



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ilogaritje të INSTAT

Importet e mallrave


Në Qershor 2020, mallrat e importuara me det zënë 47,1 %, me rrugë 48,7 % dhe me ajër 2,3 %.

Mallrat e importuara me rrugë në Qershor 2020 janë rritur me 9,9 %, krahasuar me Qershor 2019.

Në gjashtëmuajorin e parë të 2020, mallrat e importuara me det zënë 48,0 %, me rrugë 46,0 % dhe me ajër 2,9 %.

Në gjashtëmuajorin e parë të 2020, mallrat e importuara me rrugë janë ulur me 7,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Fig. 2 Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Qershor 2020



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritjet të INSTAT

Metodologji

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve, sipas llojeve, si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit, në frekuencë mujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Transport ajror: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007) është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: rrugë, hekurudhë, rrugë ujore të brendshme dhe det.

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë